



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:031082

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05636004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ—Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku dhe zyrtaren Ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale kundër të pandehurit H.D., me vendbanim në fshatin ... - komuna Lipjan, për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 paragraf 5 lidhur me paragrafi 3 dhe 2 të Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II. nr.50/24, të datës 23.02.2024, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, e mbajtur me datë 03.04.2024, në praninë e prokurorit të shtetit Ardian Emini, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, të pandehurit H.D. dhe mbrojtësit të tij me autorizim Av. Behar Sejda, me datë 03.04.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 29.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

H.D., nga i ati Xh. dhe e ëma S., e gjinisë R., i lindur më datë ... në fshatin ..., Komuna Lipjan, ku edhe tani jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion afarist, i gjendjes së mesme ekonomike, beqar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me 30 shtator 2023, rreth orës 11.00, në rrugën "...", në Ferizaj, saktësisht tek objekti banesore në ndërtim i kompanisë "F.", në cilësinë e personit përgjegjës të kompanisë kontraktuese për montimin e pllakave N.SH.“K. – P”, nga pakujdesia, ka rrezikuar jetën e njerëzve, duke mos ndërmarr masat e nevojshme për siguri dhe mbrojtje në vendin e punës

ashtu siç parashihet në shtojcën numër. 4, pika 4.1.1 të Rregullores (MPMS) nr. 06/2017 për Kriteret Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Vend ndërtimet e Përkohshme ose Mobile, ku punëdhënësi është i obliguar ta rregulloj vendin për hedhjen e mbeturinave i cili duhet të jetë i izoluar dhe askush nuk duhet të ketë qasje në të, në atë mënyrë që derisa punëtori – i dëmtuari A.D., ka qenë duke i hedhur mbetjet e pllakave nga kati i dytë në vendin e improvizuar për hedhjen e mbeturinave ka vërejtur një punëtor, nga frika se po e lëndon të njëjtin, është rrëzuar së bashku me mbeturinat, me ç’ rast ka pësuar lëndime të rënda trupore.

- Me këtë ka kryer veprën penale **Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës** nga neni 358 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 dhe 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 21, 38, 42, 43, 44, 69, 70, 358 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 dhe 2 të KPRK-së, si dhe neneve 230, 364, 452 dhe 455 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të pandehurit e :

G J Y K O N

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh, i cili me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat brenda 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.
- II. Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, të njëjtit në pajtim me nenin 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguara, i pandehuri do të vuajë 1 (një) ditë burgim.
- III. I dëmtuari A.D. me vendbanim në fshatin ..., Komuna Lipjan nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.
- IV. Obligohet i pandehuri në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet), në emër të shpenzimeve të procedurës penale-ekspertizën mjekoligjore shumë prej 20 (njëzetë) euro, si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës shumë prej 20 (njëzet) euro, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm më datë 23.02.2024, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.50/2024, kundër të pandehurit H.D., për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 dhe 2 të KPRK-së.

Prokurori i Shtetit aktakuzës së paraqitur i ka bashkangjitur edhe Marrëveshjen për pranimin e fajësisë të datës 23.02.2024, Deklaratën e të pandehurit të datës 23.02.2024 si dhe autorizimin nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj të datës 23.02.2024.

Gjyqtari i çështjes duke vepruar sipas kësaj aktakuze ka mbajtur seancën dëgjimore – publike për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, me datë 03.04.2024, në të cilën seancë i pandehuri, mbrojtësja e tij dhe prokurori i shtetit u deklaruan përkitazi me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe i kanë propozuar Gjykatës pranimin e saj sipas kushteve të përcaktuara.

2.Vlerësimi i marrëveshjes së pranimi të fajësisë

Gjatë shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoi se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 230 paragrafi 17, të KPP-së: I pandehuri H.D. ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, Av. Behar Sejda, dhe se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga prokurori dhe atë: deklarata e të pandehurit e dhënë në prokurori me datë 07.02.2024 dhe në polici me datë 29.12.2023, deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit A.D. e dhënë në prokurori me datë 07.02.2024 dhe në polici me datë 26.12.2023, raporti i oficerit i datës 30.09.2023, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 30.09.2023, Deklarata e dëshmitarit P.D. e dhënë në polici me datë 21.01.2024, Deklarata e dëshmitarit K.Sh. e dhënë në polici me datë 30.09.2023,

Dokumenti i Regjistrimit të biznesit me numër unik identifikues: ... në emër N.SH”K.-P” në pronësi të P.D., Kontrata e Punës në mes të kompanisë F. dhe kompanisë K.-p, e lidhur me datë

27.02.2023, Akt ekspertimi mjeko ligjor i datës 13.02.2024, Foto albumi me numër të rastit 2023-CF-2168 i datës 30.09.2023, Raporti zyrtar mbi aksidentin në punë i datës 30.09.2023 i përpiluar nga Inspektorati i Punës, Flet lëshimi me numër 1... i datë 10.10.2023 si dhe shkresat tjera të lëndës.

Andaj, bazuar në të gjitha këto, gjykata pranoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe bazuar në këto marrëveshje vazhdoi me shqiptimin e sanksionit penal.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri H.D., ka kryer veprën penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 dhe 2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh, i cili me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat brenda 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprën penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë: arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë para ngritjes së aktakuzës, faktin se i njëjti është përdorur për veprën penale që ka kryer dhe është hera e parë që kryen veprën penale, sjelljen e kryesit pas kryerjes së veprës penale ku i njëjti ka raporte shumë të mira me të dëmtuarin, premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej veprë të tillë dhe as vepra të tjera penale, kurse rrethana rënduese nuk gjeti.

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së e që konsistojnë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e

tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Neni 459 paragrafi 4 i KPP-së përcakton se: *“Kur personi i autorizuar nuk e ka paraqitur propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale para ngritjes së aktakuzës, ai duhet njoftuar se propozimin mund ta paraqesë deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Kur me vepër penale është shkaktuar dëm në pasurinë në pronësi publike, shtetërore ose shoqërore dhe nuk është paraqitur propozim, gjykata për këtë e njofton organin ose personin kompetent sipas nenit 458, paragrafi 2 i këtij Kodi. Pala informohet se mosparaqitja e propozimit mund ta përjashtojë palën e dëmtuar nga Programi i Kompensimit të Viktimave edhe nëse pala do të plotësonte kriteret tjera të pranueshmërisë sipas ligjit në fuqi”*. Andaj, gjykata e ka njoftuar palën e dëmtuar për këtë të drejtë, mirëpo i njëjti në seancën dëgjimore ka deklaruar se nuk paraqet kërkesë pasurore juridike.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që ta detyrojë të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro si dhe duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20 (njëzet) Euro.

Nga Formulari për kompensimin e ekspertëve mjeko –ligjor i datës 26.01.2024, përcaktohen shpenzimet lidhur me ekspertizën mjeko – ligjore në vlerë prej 20 (njëzet) euro, andaj është detyruar i pandehuri që lidhur me këtë ekspertizë të paguaj shumën në vlerë prej 20 (njëzet) euro.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
2024:063408, datë 29.04.2024

Zyrtare Ligjore,
Ardita Tasholli

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Gjykata i ka njoftuar palët se kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj, mirëpo të gjitha palët kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë.